



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:034461

Datë: 30.05.2023

Numri i dokumentit: 04341418

**PKR.nr.190/2014**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda**, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.M. nga fshati D. K- K., për shkak te veprës penale “përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm” nga neni 375 par 1 te KPK-se, sipas aktakuzës PP.nr. 243/2014 te dt. 07.08.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurores së shtetit Ersan Qavolli, të akuzuarit B.M. si dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. Bujar Berdynaj, me datë 19.05.2023 mori dhe publikisht shpalli dhe me dt.30.05.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari: **B.M.** i biri i Xh. dhe nenës N. e gjinisë Th., i lindur me dt..... në f. D. K-K., i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon ne A. ne N. J., instalim g., i gjendjes se mesme ekonomike , shqiptar shtetas i R. Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Me parë ka siguruar e gjerë me dt.27.07.2014 pa autorizim ka mbajtur armë dhe municion dhe atë një pistolë te tipit “AK-47” me numër serik ..... cal .... mm, me një karikatorë, një pistoletë te tipit M- 57 me numer serik C- ..... cal. ../.x .. mm, me një karikator dhe një fishekë te cal ....x .. mm, e te cilat armë natën kritike rreth orës 21:30 tek shtëpia e tij ne fshati D. K- K. shtënë në ajër disa here ku me te marrë informacion policia kishte dale ne vend ngjarje ku nga i pandehuri kishte konfiskuar armët dhe municionin ne fjalë.

-Me çka ka kryer vepër penale “përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm “ nga neni 375 par. 1 te KPK-se.

Andaj bazuar ne nenin nenin 7, 21, 41, 42, 43, 45, 47, 73, 74, 75, 76, 84 neni 375 par 1 te KPRK-se, si dhe nenin 364 të KPPRK-së të akuzuarin e

**G J Y K O N**

Të akuzuarit i përcaktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 ( gjashtë ) muaj.

Me pëlqimin e të akuzuarit dënimi i shqiptuar me burgim i zëvendësohet me dënimi me gjobë në shumën prej 2.500 € (dymijë e pesëqind euro). Në këtë dënimi i llogaritet koha e kaluar në paraburgim në pritje të ekstradimit nga dt.28.02.2023 e gjer me dt.19.05.2023 kur është sjell në gjykatë e që gjithsejtë janë 81 ditë të qëndrimit në paraburgim.

Pjesën e mbetur të gjobës pas përlllogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim që i bie shuma prej 820 €( tetëqind e njëzet euroa), të cilën i akuzuari obligohet ta paguaj më së largu në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftë se i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë të llogaritur për pagesë në afat të caktuar, atëherë e njëjta do të zëvendësohet në burg duke iu llogaritur një ditë burg për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës.

Të akuzuarit i konfiskohen: një pistolë te tipit “AK-47” me numër serik ..... cal .... mm me një karikatorë, një pistoletë te tipit M- 57 me numer serik C- ..... cal. ../.x .. mm me një karikator dhe një fishekë te cal ....x .. mm.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 200€ (dyqind euro ), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë, -Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP.nr. 243/2014 të datës 07.08.2014, ndaj të akuzuarit B.M. nga f. D. K- K., për shkak të veprës penale “ përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm “ nga neni 375 par 1 të KPK-se.

I akuzuari nuk është paraqitur në gjykatë dhe si pasojë gjykata ka vepruar me urdhër arrest, fletë rreshtim vendor dhe vetëm pas veprimit me letë rreshtim ndërkombëtarë është bërë e mundur që të sigurohet prezenca e të akuzuarit në procedurë.

I akuzuari është sjell në procedurën të ekstradimit nga Sh. dhe seanca e shqyrtimit gjyqësor është bërë me dt.19.05.2023, është lexuar aktakuza nga ana e Prokurorit të shtetit PP.nr. 243/2014 të datës 07.08.2014, i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij dhe gjykata është bindur se i akuzuari i ka kuptuar të drejtat e tij dhe ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për fajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin që të deklarohet për pranimit apo mospranimit të fajësisë i është dhënë mundësia që të konsultohet me mbrojtësin, duke i njoftuar me pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë duke vepruar sipas nenit 241 dhe 242 par.2 pika 2.1 deri 2.4 të KPPRK-së. Gjykata është bindur se i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimit të fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës, pranimit të fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuar nga prokurori i shtetit.

I akuzuari pas konsultimit me mbrojtësin e tij ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e pranoi vullnetarisht pa kurrfarë presioni.

Mbrojtësi av. Bujar Berdynaj ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë kërkoi nga Gjykata që të aprovon këtë pranim fajësie.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë, për shkak se ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe një gjë e tillë është bërë në prokurori dhe në polici.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hüdhe të aktakuzës konform nenit 248 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 241 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave por gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestarë nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana për përjashtimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj i akuzuari është penalisht përgjegjës.

Gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i hetuesit policor L. A. me numër ....-...-... te dt. 27.07.2014, dëftesa mbi konfiskimin e armëve me numër te njëjtte te datës 27.07.2014, raporti i bastisjes se shtëpisë se te pandehurit te dt. 27.07.2014, raporti i shpejtë me numër te njëjtte te dt. 27.07.2014, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat për dënimin konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoj se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës, nuk evidentohet si kryes i ndonjë veprë penale. Nga rrethanat rënduese gjykata vlerësoj sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale ku i njëjti për vite të tëra i është shmangur gjykatës, deri sa është siguruar nëpërmes letë rreshtimit ndërkombëtarë nëpërmes procedurës së ekstradimit pasi që ishte arrestuar në Shtetin e Republikës së Shqipërisë.

Për veprën penale për të cilën u shpall fajtor i akuzuari si në dispozitiv të këtij aktgjykimi parashihet dënim me burgim nga 1 deri në 8 vite. Mirëpo Gjykata bazuar në rrethanat e lartcekura e veçanërisht në pranimin e fajësisë ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor, konform në nenin 75 dhe 76 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së, dispozita këto ku parashihet zbutja e dënimit nën minimumin e paraparë ligjorë.

Gjykata pasi që ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj, bazuar në dispozitën e nenit 47 të KPRK-së me pëlqimin e të akuzuarve të dhënë pas shpalljes së aktgjykimit, dënimin me burg e ka zëvendësuar në dënim me gjobë.

Gjykata bazuar në të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, siç është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, gjithnjë duke u bazuar nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata të akuzuarit i ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 84 të KPRK-së lidhur me nenin 39 par. 3 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar ku parashihet: nëse personi i ekstraduar ka qenë në paraburgim në shtetin e huaj për veprën penale për të cilën ai apo ajo është ekstraduar, koha e kaluar në paraburgim

llogaritet në dënimin e shqiptuar (vendimi me nr.Regj. Th. ..., dt.02.03.2023 nga i cili rezulton se i akuzuari ishte arrestua me dt.28.02.2023 dhe shkresat dhe dokumentacionet tjera të ekstradimit të R. së Sh.).

Konform nenit 375 par.3 të KPRK-së të akuzuarit i janë konfiskuar armët e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 449 dhe 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të paushallit gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin e pagesën e taksës për viktimat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

**2018:034461, 30.05.2023**

**Kryetarja e trupit gjykues**

---

Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.